



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 5 shkurt 2018
Nr. ref.: RK 1191/18

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI45/17

Parashtrues

Nexhat Krasniqi

Vlerësim i kushtetutshmërisë së
Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, Pml. nr. 329/2016,
të 2 marsit 2017

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare dhe
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare.

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Nexhat Krasniqi nga Prishtina (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës), të cilin e përfaqëson Florent Latifaj, avokat nga Prishtina.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston Aktgjykimin [Pml. nr. 329/2016] të Gjykatës Supreme, të 2 marsit 2017, në lidhje me Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit PAKR. nr. 603/2015, të 20 majit 2016 dhe Aktgjykimit të Gjykatës Themelore të Prishtinës, PKR. nr. 144/2013, të 21 shtatorit 2015.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes së kërkesës është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, me të cilin pretendohet se parashtruesit të kërkesës i janë shkelur të drejtat dhe liritë e garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), si dhe me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ).

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës, në nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 29 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 14 prill 2017, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
6. Më 18 prill 2017, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtaren Snezhana Botusharova gjyqtare raportuese dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Altay Suroy (kryesues), Arta Rama-Hajrizi dhe Gresa Caka-Nimani.
7. Më 28 prill 2017, Gjykata e njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës dhe ia dërgoi një kopje të kërkesës Gjykatës Supreme.
8. Më 14 nëntor 2017, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

9. Parashtruesi i kërkesës ka qenë i punësuar në pozitën e drejtorit të Departamentit të Prokurimit në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë.
10. Më 22 korrik 2005, Ministria e Tregtisë dhe Industrisë shpalli tender për *“Projektimin dhe Ndërtimin e Infrastrukturës së Parkut Industrial në Drenas”*.
11. Më 7 tetor 2005, u nënshkrua kontrata në mes të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë dhe Kompanisë “Eltoni” për projektin dhe ndërtimin e infrastrukturës së parkut industrial në Drenas, në vlerë prej 144.000 euro/çmim për njësi 69.825,25 euro (pa përmendur numrin e njërive).

12. Më 20 korrik 2006, në mes të Kompanisë “Eltoni” dhe Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, është nënshkruar një aneks-kontratë të nënshkruar nga [parashtruesi i kërkesës] në emër të Ministrisë, në të cilën thuhet *“Duke pasur parasysh se palët e përmendura më lart kanë lidhur një kontratë për kryerjen e punimeve në projektin Parku Industrial në [Drenas, (...) duke u bazuar në punimet e kryera nga kontraktori dhe kërkesës së tij në ndryshimin e kushteve të pagesës dhe me miratimin nga MTI-ja, ku palët bien dakord për të ndryshuar reciprokisht kushtet e pagesës (...) Kanë rënë dakord si më poshtë: C ...) Neni 1 (në lidhje me ndryshimin e klauzolave 17.3 deri në 17.5), nenin 2 (rreth pagesave të bëra sipas “situacioneve”) (...) Neni 4: Vlera e përgjithshme e kontratës do të jetë 1.730.000 euro (...)”*.
13. Më 5 nëntor 2012, Prokuroria Themelore në Prishtinë ngriti aktakuzën kundër parashtruesit të kërkesës për veprën penale shpërdorimi i detyrës zyrtare ose i autorizimit nga neni 339, paragrafi 3, lidhur me nenin 23 të Kodit Penal të Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: KPK) dhe veprën penale mashtrimi në detyrë nga neni 341, paragrafi 1 dhe 3, lidhur me nenin 23 të KPK-së.
14. Më 21 shtator 2015, Gjykata Themelore në Prishtinë nxori Aktgjykimin PKR. nr. 144/2013, me të cilin e shpalli parashtruesin e kërkesës fajtor për veprat penale dhe e gjykoji me dënim unik, me burgim në kohëzgjatje prej 26 muajve.
15. Gjykata Themelore konsideroi që:

“Përkundër faktit se shuma e kontratës fillestare të datës 07/10/2005 është ndryshuar vetëm me aneks-kontratën e parë (neni 4 i saj), të datës 20/07/2006, një muaj përpara kësaj, me datën 20/06/2006 [parashtruesi i kërkesës] tashmë e kishte parashtruar në Agjencinë e prokurimit publik, në pajtim me nenin 34, par. 3 (mes tjerash), të Ligjit mbi prokurimin nr. 2003/17, Kërkesën për shfrytëzimin e procedurave të kufizuara apo të negociuara për punët shtesë, në të cilën thuhej: “vlera e përafërt e kontratës: 1.700.000 euro. vlera e parashikuar: vlera e punëve shtesë: 14.580 euro”, kur asokohe (me 20/06/2006) shuma e kontratës së datës 07/10/2005 (kontratës së vetme ekzistuese) kishte qenë 144.000 euro/çmimi për njësi 69.825.25 euro, e jo 1.700.000 euro”.
16. Parashtruesi paraqiti ankesë në Gjykatën e Apelit kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore duke pretenduar vërtetim të gabuar të gjendjes faktike, interpretim të gabuar të dispozitave ligjore me të cilat rregullohen çështjet financiare të Ligjit për Prokurimin, si dhe lidhur me kohëzgjatjen e dënimit të shqiptuar.
17. Më 2 maj 2016, Gjykata e Apelit nxori Aktgjykimin PAKR. nr. 603/15, me të cilin e pranoi pjesërisht ankesën e parashtruesit përkitazi me cilësimin juridik të veprës penale, si dhe me kohëzgjatjen e dënimit. Në këtë mënyrë, dënimin me burgim të parashtruesit e zvogëloi nga 26 muaj burgim në 18 muaj dënim me kusht. Në arsyetimin e Aktgjykimit, Gjykata e Apelit theksoi:

“[...] Kolegji më pastaj i ka rishikuar me kujdes argumentet e prezantuara në ankesë dhe në propozimin e prokurorit të apelit.

Kolegji i ka ekzaminuar në mënyrë të hollësishme gjetjet faktike në aktgjykimin e kundërshtuar dhe pajtohet në tërësi me gjetjet në fjalë. Gjykata Themelore në aktgjykimin e kundërshtuar i ka analizuar në detaje provat e administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor lidhur me të pandehurin (parashtruesin). Në pikëpamjen e Kolegjit, gjykata e shkallës së parë ka arritur në konkluzione të logjikshme gjatë vlerësimit të provave.

Gjykata e Apelit konstaton se ka prova të mjaftueshme për të provuar përtej dyshimit të arsyeshëm se i pandehuri (parashtruesi) ka kryer veprën penale të keqpërdorimit të pozitës apo autoritetit zyrtar, në bashkëkryerje, në kundërshtim me nenin 422 (1), lidhur me nenin 31 të KPK-së ...”.

18. Parashtruesi paraqiti në Gjykatën Supreme kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore, PKR. nr. 144/2013, të 21 shtatorit 2015 dhe Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, PAKR. nr. 603/2015, të 20 majit 2016, në të cilën pretendoi “shkeljet thelbësore të dispozitave të procedurës penale dhe shkelje të ligjit penal”.
19. Më 21 shkurt 2017, Gjykata Supreme nxori Aktgjykimin Pml. nr. 329/2016, me të cilin e refuzoi si të pabazuar kërkesën e parashtruesit për mbrojtje të ligjshmërisë. Në arsyetimin e Aktgjykimit theksohet:

“Sa i përket veprës së parë penale, u konstatua se kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë e mbrojtësit të dënuarit, kryesisht ka të bëjë me pretendimin se akuza është tejkualuar sepse në aktakuzë është cekur se vepra penale është kryer me qëllim që i dënuari vetës të sjell fitim pasuror të kundërligjshëm ndërsa është shpallur fajtor për shkaktimin e dëmit ... Mirëpo, kjo gjykatë konstatojë se nuk është bërë tejkalimi i aktakuzës sepse asaj nuk i është shtuar asnjë fakt i rëndësishëm që aktakuzën e kishte ndryshuar në atë masë sa që gjykata kishte për të gjykuar një çështje tjetër nga ajo e dhënë në aktakuzë.

[...]

... Sa i përket veprës së dytë penale, Gjykata Supreme konstatoi se aktgjykimet e kundërshtuara nuk janë të përfshira me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale të cilat pretendohen në kërkesat për mbrojtje të ligjshmërisë”.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

20. Parashtruesi i kërkesës pretendon se të gjitha gjykatat e rregullta kanë shkelur të drejtën e tij për gjykim të drejtë në përcaktimin e akuzave penale kundër tij siç garantohet me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës dhe nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së.
21. Parashtruesi konsideron se gjykatat shkelën të drejtat e tij për shkak se ato nuk e pranuan kërkesën e tij për ekspertizë shtesë lidhur me metodologjinë faktike të procedurave të prokurimit qeveritar në Kosovë. Parashtruesi i kërkesës pretendon se gjykatat e rregullta nuk arritën të kuptonin siç duhet implikimet

financiare të sistemit kontraktues të prokurimit siç zbatohen në kontratën që formoi bazën e akuzave penale kundër tij.

22. Parashtruesi i kërkesës pretendon se *“parimi i barazisë së armëve kërkon që secilës palë t’i jepet një mundësi e arsyeshme për të paraqitur rastin dhe provat e saj, dhe të propozojë edhe ekspertizën, nën kushtet që nuk e vendosin atë në një pozitë të pafavorshme vis-a-vis një pale tjetër.”*
23. Parashtruesi i kërkesës, më tej, pretendon se gjykatat e rregullta nuk arritën të kuptonin saktësisht kushtet e kontratave që ai kishte nënshkruar në emër të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë për “Parkun Industrial në Drenas”, në veçanti lidhur me vlerën e përgjithshme të kontratës.
24. Parashtruesi i kërkesës argumenton se është *“shkelur parimi kushtetues i ndalimit të arbitraritetit në vendimmarrje, sepse arsyetimi i dhënë nuk i përmban faktet e përcaktuara, dispozitat ligjore dhe marrëdhënien logjike ndërmjet tyre siç e konfirmon edhe vetë shkalla e parë dhe shkalla e dytë”*.
25. Parashtruesi kërkon nga Gjykata që *“të anulohen vendimet e gjykatave të rregullta dhe çështja të kthehet në rishqyrtim në Gjykatën Themelore në Prishtinë dhe rivendosje nga kjo Gjykatë dhe të evitohen shkeljet kushtetuese të nenit 31 të Kushtetutës si dhe nenit 6 të KEDNJ-së”*.

Pranueshmëria e kërkesës

26. Gjykata së pari do të shqyrtojë nëse kërkesa i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë, të parapara më tej me Ligj dhe të parashikuara me Rregullore të punës.
27. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7, të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, të cilët përcaktojnë:

*“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.
(...)”*

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”

28. Gjykata gjithashtu i referohet nenit 49 [Afatet], i cili parasheh:

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor.”

29. Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar; kërkesa është dorëzuar në pajtim me afatet e përcaktuara në nenin 49 të Ligjit dhe se parashtruesi i ka shteruar të gjitha mjetet juridike.
30. Megjithatë, Gjykata i referohet edhe nenit 48 të Ligjit [Saktësimi i kërkesës], i cili parasheh:

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj”.

31. Gjykata më tej i referohet rregullit 36 (1) (d) dhe (2) (b) të Rregullores së punës, i cili përcakton:

“(1) Gjykata mund ta shqyrtojë një kërkesë nëse:

[...]

d) kërkesa arsyetohet prima facie ose nuk është qartazi e pabazuar.

(2) Gjykata do të deklarojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se:

[...]

b) faktet e paraqitura në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e një të drejte kushtetuese”.

32. Në rastin konkret, Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës pretendon shkelje të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës lidhur me nenin 6 të KEDNJ-së, sepse:

“a) ai gjatë gjykimit nuk e ka pasur mundësinë e njëjtë për të paraqitur rastin dhe provat e tij, sepse gjykatat e kishin refuzuar kërkesën e tij për ekspertizë financiare, me të cilin është shkelur parimi i barazisë së armëve, dhe

b) ka ekzistuar arbitrariteti në vendimmarrjen e gjykatave të rregullta, sepse arsyetimet e dhëna nuk i përmbajnë faktet e vërtetuara, dispozitat ligjore dhe marrëdhënien logjike ndërmjet tyre”.

33. Gjykata vëren se parashtruesi përsërit të njëjtat argumente që ai kishte parashtruar në procedurat para gjykatave të rregullta, në veçanti, lidhur me kërkesën e tij për një dëshmitar ekspert, vlerësimin e provave dhe përcaktimin konsekuent të gjendjes faktike.

34. Gjykata vëren se të tri instancat e gjykatave të rregullta kanë trajtuar këtë çështje dhe do të elaborohet më tej në paragrafët e ardhshëm.

35. Përveç kësaj, Gjykata rikujton praktikën e saj gjyqësore, me të cilën është konstatuar që

“nuk është detyrë e saj sipas Kushtetutës të veprojë si Gjykatë e Apelit, ose një gjykatë e shkallës së katërt, në lidhje me vendimet e marra nga gjykatat e rregullta, roli i këtyre të fundit është t’i interpretojnë dhe t’i zbatojnë rregullat e të drejtës procedurale dhe materiale” (shih: mutatis mutandis, García Ruiz kundër Spanjës [DHM], nr. 30544/96, paragrafi 28, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut [GJEDNJ] 1999-I).

Gjykata Kushtetuese mund të shqyrtojë vetëm nëse provat janë paraqitur në atë mënyrë dhe procedurat në përgjithësi, të shikuara në tërësinë e

tyre, janë kryer në mënyrë të tillë që parashtruesi të ketë pasur një gjykim të drejtë (shih, Aktgjykimi i Gjykatës Kushtetuese i 23 qershorit 2010, Korporata Energjetike e Kosovës kundër 49 aktgjykimeve individuale të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, paragrafët 66 dhe 67). (Shih Aktvendimin për papranueshmëri të Gjykatës Kushtetuese të 18 tetorit 2010, Karfeta kundër Gjykatës Supreme, KI42/09, para. 18, 19).

36. Gjykata rikujton se në pajtim me nenin 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës *“të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut”*.
37. Në këtë drejtim, Gjykata rithekson se Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejshëm: GJEDNJ) ka përcaktuar se *“roli i gjykatave të rregullta është t’i interpretojnë dhe t’i zbatojnë rregullat e të drejtës procedurale dhe materiale (shih: Aktgjykimi i GJEDNJ-së i 21 janarit 1999, Garcia Ruiz kundër Spanjës, [GC], nr. 30544/96, paragrafi 28.”*
38. Gjykata gjithashtu përkujton praktikën konsistente të GJEDNJ-së, e cila ka konstatuar se, *“Si rregull i përgjithshëm, gjykatat kombëtare, dhe në veçanti gjykata e shkallës së parë, duhet të vlerësojnë provat para tyre, si dhe rëndësinë e provave të cilat i akuzuari kërkon t’i paraqesë (shih të njëjtin aktgjykim, fq.15, paragrafi 33, paragrafi i dytë në gjobë). Megjithatë, Gjykata duhet të përcaktojë - dhe në këtë pajtohet edhe me Komisionin - nëse procedurat e shqyrtuara si tërësi, duke përfshirë mënyrën se si janë marrë provat e prokurorisë dhe të mbrojtjes, kanë qenë të drejta siç kërkohet me nenin 6, par. 1 (neni 6-1)”* (shih Aktgjykimin e GJEDNJ-së të 6 dhjetorit 1988, Barbarà, Messegué dhe Jabardo kundër Spanjës, nr. 10590/83, paragrafi 68).
39. Gjykata thekson se nuk është detyrë e Gjykatës Kushtetuese të merret me gabimet e faktit ose të ligjit që pretendohet të jenë bërë nga gjykatat e rregullta gjatë vlerësimit të provave apo zbatimit të ligjit (ligjshmëria), përveç dhe për aq sa ato të mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Kushtetutë (kushtetutshmëria).
40. Gjykata përsërit se është përtej kompetencës së saj të vlerësojë cilësinë e konkluzioneve të arritura nga gjykatat e rregullta lidhur me vlerësimin e provave, përveç nëse ato konkluzione janë qartazi arbitrare apo çojnë në një rezultat qartazi arbitrar.
41. Në rastin konkret, lidhur me pretendimin e parashtruesit për shkeljen e parimit të “barazisë së armëve”, Gjykata konsideron se sipas nenit 6, paragrafi 3 pika d) të KEDNJ-së, palës nuk i jepet një e drejtë e pakufizuar për t’i dëgjuar dëshmitarët, ose për t’i paraqitur provat e tjera para Gjykatës, por, sipas rregullit, detyra e gjykatave të rregullta është të vlerësojnë nëse është e nevojshme që të ftohen dëshmitarët e caktuar, si dhe nëse deklaratat e dëshmitarëve të propozuar apo paraqitja e provave tjera të propozuara dhe veprimeve të tjera do të ishin relevante dhe të mjaftueshme për vendimmarrjen në rastin konkret (shih: vendimin e pjesshëm të GJEDNJ-së për pranueshmëri, Harutyunyan kundër Armenisë, nr. 36549/03).

42. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se Gjykata Themelore në Aktgjykimin e saj PKR. nr. 144/2013 theksoi se vendimi i saj është arritur *“në bazë të vlerësimit të ndërgjegjshëm të çdo prove një nga një dhe në lidhje me provat e tjera dhe në bazë të vlerësimit të tillë të nxjerrë një përfundim për ekzistencën e faktit konkret”*, që sipas mendimit të kësaj Gjykate, ajo i është përmbajtur kësaj gjatë gjithë procedurës.
43. Për më tepër, Gjykata vëren se Gjykata e Apelit dhe Gjykata Supreme në aktgjykimet e tyre kanë dhënë arsytetime të qarta dhe të hollësishme, si për çështjen e provave të cilat janë pranuar dhe administruar nga Gjykata Themelore, ashtu edhe për çështjen e provave dhe dëshmitarëve të cilët janë refuzuar nga kjo gjykatë.
44. Gjykata konsideron se në vendimet e kontestuarra të gjykatave është theksuar në mënyrë të qartë dhe të argumentuar se rrethanat për shkak të të cilave parashtruesi e propozoi dëgjimin e ekspertit financiar, nuk ishin të nevojshme për vërtetimin e fakteve, dhe se, rrjedhimisht, administrimi i këtyre provave dhe veprimeve ishte i panevojshëm.
45. Gjykata gjithashtu rikujton pretendimin e dytë të parashtruesit *“se ka pasur arbitraritet në vendimmarrjen e gjykatave të rregullta, sepse arsyetimi i dhënë nuk përmban faktet e vërtetuara, dispozitat ligjore dhe një raport logjik ndërmjet tyre”*.
46. Gjykata tanimë kishte vërejtur se gjykatat e rregullta zhvilluan procedurë të gjerë dhe gjithëpërfshirëse në të cilën janë administruar provat e paraqitura nga të dyja palët, edhe të mbrojtjes edhe të prokurorisë. Për më tepër, gjykatat e rregullta adresuan kërkesën e parashtruesit për një dëshmitar ekspert dhe arsyetuan se pse ato nuk e konsideruan të nevojshme këtë ekspertizë shtesë.
47. Duke pasur parasysh të lartcekurat, Gjykata konsideron se gjykatat e rregullta kanë dhënë argumente të qarta dhe të sakta për të mbështetur të gjitha gjetjet dhe konkluzionet e tyre. Rrjedhimisht, Gjykata nuk mund t'i vlerësojë procedurat në gjykatat e rregullta si arbitrare.
48. Në këto rrethana, Gjykata konsideron se asgjë në rastin e paraqitur nga parashtruesi i kërkesës nuk tregon se procedurat në gjykatat e rregullta ishin të padrejta ose arbitrare në mënyrë që Gjykata Kushtetuese të arrijë në përfundim se ishte shkelur thelbi i së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, ose se parashtruesi i kërkesës ishte i privuar nga ndonjë garanci procedurale, e cila mund të çojë në shkelje të asaj të drejte sipas nenit 31 të Kushtetutës, ose paragrafit 1, të nenit 6 të KEDNJ-së.
49. Gjykata konsideron se është obligim i parashtruesit të kërkesës që t'i dëshmojë pretendimet e tij kushtetuese dhe të paraqesë dëshmi *prima facie* që tregon shkeljen e të drejtave të garantuara me Kushtetutë dhe KEDNJ. Ky vlerësim është në përputhje me juridiksionin e Gjykatës (shih: rastin e Gjykatës Kushtetuese nr. KI19/14 dhe KI21/14, parashtruesit e kërkesës *Tafil Qorri dhe Mehdi Sylja*, të 5 dhjetorit 2013).

50. Si përmbledhje, Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës nuk i ka dëshmuar pretendimet e tij dhe as nuk ka paraqitur ndonjë dëshmi *prima facie* që tregon shkeljen e të drejtave të garantuara me Kushtetutë dhe KEDNJ.
51. Prandaj, kërkesa e parashtruesit është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese dhe duhet të deklarohet e papranueshme në pajtim me rregullin 36 (1) (d) dhe (2) (b) të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të nenit 113.7 të Kushtetutës, të nenit 47 të Ligjit dhe të rregullit 36 (1) (d) dhe (2) (b) të Rregullores së punës, më 14 nëntor 2017, njëzëri

VENDOS

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese



Snezhana Botusharova



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese



Arta Rama-Hajrizi